



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 856
Datë: 15/3/2024

Në bazë të nenit 22, të Rregullores, nr.753 për procedurën zgjedhore, themelimin dhe punën e Parlamentit Studentor dhe Këshillave të Studentëve, në mbledhjen e mbajtur datë 15.03.2024, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ-UP), në mënyrë unanime nxjerr këtë:

VENDIM

1. Certifikohen për pjesëmarrje në zgjedhjet studentore 2024, Organizatat Studentore si në vijim:
 - 1.1. Iniciativa Studentore Progresi i Universitetit të Prishtinës (ISP UP);
 - 1.2. Koalicioni parazgjedhor i përbërë nga organizatat studentore: Unioni Demokratik Studentor (UDS), Opinioni i Pavarur Studentor (OPS);
 - 1.3. Lëvizja Studentore për Barazi STUDIM, KRITIKË, VEPRIM (SKV);
 - 1.4. Reforma në Proces (RNEP);
 - 1.5. Unioni i Studentëve Pro Evropian (USPE).
2. Refuzohet certifikimi i organizatës studentore, Paqja Studentore (PS UP).
3. Të gjitha Organizatat Studentore të certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje, sipas këtij vendimi mund t'i dorëzojnë listat e kandidatëve, sipas afatit të përcaktuar në dinamikën zgjedhore, për të gjitha nivelet e përfaqësimit, respektivisht Parlamentin e Studentëve dhe Këshillat e Studentëve.
4. Shorti për paraqitjen në fletëvotim, të Organizatave Studentore do të hedhet me datë 15.03.2024, në ora 14:30, duke filluar nga numri 12 deri në 16. Tërheqja e numrave do të bëhet nga përfaqësuesit e Organizatave Studentore, sipas renditjes në këtë vendim.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga KQZ UP.

ARSYETIM

Në mbledhjen e mbajtur, me datë 08.03.2024, KQZ UP ka miratuar dinamikën zgjedhore, sipas të cilës ka përcaktuar, bazuar në nenin 22 të Rregullores nr. prot: 753, datë 7.3.2024 për procedurat zgjedhore, themelimin dhe punën e Parlamentit Studentor dhe Këshillave të Studentëve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina. Sipas dinamikës së miratuar nga KQZ UP, afati për aplikimin e organizatave studentore, për pjesëmarrje në zgjedhje ka qenë data **15.03.2024, ora 12:00**.

Përmes emailit zyrtar të KQZ UP, me 11 Mars 2024, në ora 09:03, Organizatave Studentore i është dërguar një njoftim për aplikim në zgjedhje, ku u është kërkuar që aplikimin ta bëjnë përmes emailit të KQZ UP kqz@uni-pr.edu dhe se në aplikim të bashkëngjisin dokumentet vijuese: 1. Certifikatën e regjistrimit të OS, pranë ministrisë përkatëse kompetente për Administratë Publike; 2. Statutin e OS; 3. Letër konfirmimin e OS që gjenerohet nga sistemi elektronik (DOJQ); 4. ID kartelën e personit të autorizuar të OS, që dëshmon se ai/ajo

aktualisht ka statusin e studentit/es; 5. Letërnjoftimin e përfaqësuesit të autorizuar të OS; 6. Deklaratën e përbashkët të OS, nëse ka të tillë që në zgjedhje aplikojnë si koalicionë para zgjedhore. Me datë 14 Mars 2024, në orën 09:48, KQZ UP, i ka dërguar edhe një njoftim shtesë të gjitha Organizatave Studentore (OS), sipas të cilit OS janë të obliguara, që përfaqësuesin e tyre, i regjistruar në Ministrinë përkatëse, respektivisht në Departamentin e OJQ-ve, ta kenë student aktiv dhe se OS obligohen që të sjellin dëshmitë, që përfaqësuesi i tyre është student aktiv, me arsyetimin se Rregullorja nr. prot: 753, 7.3.2024, të drejtë vote i ka lejuar vetëm studentëve që kanë statusin aktiv dhe ka të regjistruar vitin përkatës akademik. Për këtë arsye, KQZ UP ka kërkuar që në aplikacionin e OS me rastin e aplikimit për pjesëmarrje në zgjedhjet studentore, ta përfshijnë edhe dëshminë që përfaqësuesi i tyre i autorizuar është student aktiv.

Bazuar në njoftimin e KQZ UP, me datë 11 Mars dhe sqarimin e datës 14 Mars 2024, të gjitha OS kanë dorëzuar aplikacionet për pjesëmarrje në zgjedhje. Aplikacionet janë dorëzuar si në vijim:

1. Paqja Studentore (PS UP), aplikacioni i dorëzuar me 13.03.2024, në ora 8:05, person i autorizuar i deklaruar Florian Murseli;
2. Organizata Studentore Reforma në Proces (RNEP), aplikacioni i dorëzuar me 14.03.2024, në ora 15:29, person i autorizuar i deklaruar Ismet Krasniqi;
3. Unioni i Studentëve Pro Evropian (USPE UP), aplikacioni i dorëzuar me datë 14.03.2024, në ora 23:58, përfaqësues i autorizuar i deklaruar Fisnik Tërshana;
4. Lëvizja Studentore për Barazi, Studim, Kritikë, Veprim (SKV), aplikacioni i dorëzuar me datë 14.03.2024, në ora 16:57, përfaqësues i autorizuar, i deklaruar Kledi Kabashi;
5. Unioni Demokratik Studentore (UDS) dhe Opinioni i Pavarur Studentor (OPS), aplikacioni i dorëzuar si koalicion parazgjedhore, me datë 15.03.2024, në ora 11:36, me përfaqësues të autorizuar i deklaruar Jeton Deliu;
6. Iniciativa Studentore Progresi (ISP UP), aplikacioni i dorëzuar me 15.03.2024 në ora 11:57 (3 minuta para mbylljes së afatit), me përfaqësues të deklaruar, Granit Geci.

Bazuar në Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, KQZ UP, përgjatë takimit i ka kërkuar të gjitha OS, informacione shtesë dhe dëshmi, lidhur me vërtetimin që përfaqësuesi i tyre i autorizuar, i deklaruar, është student aktiv dhe që ka regjistruar vitin akademik 2023/2024. Të gjitha organizatat studentore të certifikuar, sipas sqarimeve të dhëna edhe më herët, kanë sjellë vërtetimin që përfaqësuesi i tyre i autorizuar është student aktiv. OS Paqja Studentore (PS UP), nuk ka sjellë dëshmi që përfaqësuesi i tyre i autorizuar është student aktiv. Lidhur me statusin e përfaqësuesit të autorizuar, të deklaruar nga PS UP, KQZ UP ka marrë përgjigje zyrtare edhe nga Komisioni Zgjedhor i Fakultetit Juridik, sipas të cilës rezultoi që *“Studenti - Florian Murseli, i regjistruar në vitin akademik 2021/2022 (studimet master), me nr. të ID-se 210402200011 është e regjistruar në vitin akademik 2021/2022 dhe ka regjistruar semestrat në vitin akademik 2021/2022 (absolvent në vitin 2022-2023 pa pagesë), ndërsa në vitin 2023/2024, nuk ka regjistruar semestra, studenti në fjalë nuk është aktiv”*.

Siç u theksua, KQZ UP, i ka njoftuar organizatat studentore, që përfaqësuesi i autorizuar duhet të jetë student aktiv dhe se të gjitha organizatat studentore të certifikuar, i janë përmbytur njoftimit dhe dinamikës së KQZ UP, përveç OS Paqja Studentore (PS UP). Andaj, për faktin që përfaqësuesi i autorizuar nuk ka qenë student aktiv, OS PS UP, i është refuzuar certifikimi për pjesëmarrje në zgjedhje.

Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative, LPPA, në nenin 4.1 përcakton: “1. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca”. Në rastin konkret, KQZ UP ka qenë e obliguar që të veproj sipas Ligjit dhe rregullave administrative të zbatueshme brenda kompetencave të saj, respektivisht Rregullores nr. prot: 753, datë 7.3.2024 për procedurat zgjedhore, themelimin dhe punën e Parlamentit Studentor dhe Këshillave të Studentëve të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Gjithashtu, KQZ UP, me datë 15.03.2024, në ora 12:08 min (8 minuta para mbylljes së afatit për aplikim të OS zgjedhje), ka pranuar një deklaratë, të pa vulosur, të nënshkruar në mes të USPE UP dhe PS UP, sipas të cilës, këto dy organizata do të garonin me një listë të përbashkët në zgjedhje. Megjithatë, ky aplikacion ishte i pa kompletuar dhe se ishte dorëzuar jashtë kohës që përcaktuar në dinamikën zgjedhore, si dhe OS respektive, tanimë kishin aplikuar në zgjedhjet studentore 2024, si organizata të ndara. Andaj, KQZ UP nuk e ka trajtuar fare përmbajtjen e kësaj deklarate, të dërguar nga USPE UP. KQZ UP thekson se sipas nenit 22.5 i Rregullores nr. prot: 753, datë 7.3.2024 për procedurat zgjedhore, themelimin dhe punën e Parlamentit Studentor dhe Këshillave të Studentëve të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” përcaktohet se “Secili veprim i ndërmarrë jashtë dinamikës zgjedhore është i pavlefshëm”.

Andaj, bazuar në elaborimin e fakteve të mësipërme, KQZ UP ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur ndaj këtij vendimi, mund të parashetrojë ankesë, në afat prej 30 ditëve, sipas Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

KQZ UP

Prof. Ass. Dr. Florent Muçaj – Kryesues



Prof. Ass. Dr. Kujtime Boshtrakaj Camaj - Zv. Kryesuese

Besfort Krasniqi, Sekretar i Përgjithshëm – Anëtar